



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr.5324/6 Prot.

Tiranë më 06.09.2018

VENDIM

Nr. 27, datë 06.09.2018

“Mbi saktësimin e emërtimeve në titujt e disa diplomave të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 7; neni 38, pika 1, gërma “dh”; në Udhëzimin Nr 25, datë 10.11.2017 “Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, neni 4; si dhe në propozimin e Departamentit të Letërsisë dhe Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, me shkresën Nr.720 Prot., datë 02.07.2018, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 06.09.2018,

VENDOSI:

I. Të miratojë propozimin e Departamentit të Letërsisë dhe Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, për saktësimet e mëposhtme:

1. Departamenti i Letërsisë:

- Diploma ekzistuese “Master i shkencave” në “Studime Letrare” të bëhet: **“Master i shkencave” në “Letërsi”**
- profili ekzistues i kësaj diplome “Teori letërsie dhe kritikë letrare” të bëhet: **“Teori dhe kritikë letrare”**
- profili ekzistues i kësaj diplome “Studime letrare shqiptare dhe antropologji kulturore” të bëhet: **“Studime letrare shqipe dhe antropologji kulturore”**

2. Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit

- profili ekzistues “Marrëdhënie publike” i diplomës “Master i Shkencave” në “Gazetari dhe Komunikim” të bëhet: **“Marrëdhënie me publikun”**
- profili ekzistues “Marrëdhënie europiane dhe ndërkombëtare”, i diplomës “Master i Shkencave” në “Gazetari dhe Komunikim” të bëhet: **“Gazetari europiane dhe ndërkombëtare”**

II. Ky vendim i përcillet QSHA-së për pasqyrimin e ndryshimeve në Regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

KRYETARI

PROF.DR. MYNYR KONI